

VENDIM
Nr. 1103, datë 28.12.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
ARSIMIT DHE SPORTIT TE MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, TË SIPËRFAQES SË TOKËS BUJQËSORE
21.4 HA, ZONA KADASTRALE 1323, FSHATI BURONJË, DELVINË, DHE PËR NJË
SHTESË NË VENDIMIN NR. 820, DATË 13.10.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, TË CILAT
I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës prej 21.4 (njëzet e një pikë katër) ha, tokë arë, ngastrat me numrat kadastralë 4, 8, 10 e 12, të ndodhura në zonën kadastrale 1323, fshati Buronjë, Delvinë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’u përdorur nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në kuadër të politikave dhe strategjisë së këtij institucioni për shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës bujqësore dhe vënien në efikasitet të tokave të pakultivuara dhe të lëna djerrë.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, për nxitjen e investimeve në bujqësi dhe blegtori, nëpërmjet shfrytëzimit të tokës bujqësore.

3. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nuk mund të ndryshojë destinacionin e pronës së përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, funksioni kryesor i së cilës është prodhimi bujqësor.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


PLAN VENDOSJE

PARCELAT me Nr kadastral 4; 8; 10; 12 Tokë Arë Prone e Drejtorisë Arsimi Dëlvine Ministria e Arsimit Tirane

Vendi: Fshati Buronje (Mavropull) Komuna Finiq

Sipërfaqja e Përgjithshme = 21.4ha

Shkalla 1:5000



Zona Kadastrale 1323

Indeksi i Hartës 1-34-5- (50-D)

Vendi Fshati Buronje (Mavropull)

Sipërfaqja (kater parcelat) = 21.4ha Tokë Arë

KUFIZIMET

Veriu Toka të Shtetit

Jugu mali Finiqit

Lindje Toka të Shtetit

Perendimi Toka të Mavropullit

KOORDINATAT

Te Sipërfaqes = 21.4ha Tokë Arë

1	y=419124.29	x=4421910.30
2	y=419197.47	x=4422019.64
3	y=419255.39	x=4421934.25
4	y=419283.09	x=4421920.28
5	y=419326.13	x=4421925.01
6	y=419365.33	x=4421939.29
7	y=419403.27	x=4422017.61
8	y=419479.96	x=4422089.12
9	y=419533.67	x=4422085.83
10	y=419554.29	x=4422034.94
11	y=419552.97	x=4421986.30
12	y=419670.33	x=4421799.96
13	y=419684.91	x=4421794.33
14	y=419798.94	x=4421913.13
15	y=419897.04	x=4421766.50
16	y=419898.04	x=4421658.94
17	y=419812.42	x=4421669.93
18	y=419657.39	x=4421500.04
19	y=419639.31	x=4421420.79
20	y=419549.74	x=4421386.25
21	y=419519.17	x=4421338.64
22	y=419495.93	x=4421282.52
23	y=419480.84	x=4421282.29
24	y=419457.99	x=4421382.71
25	y=419448.25	x=4421475.93
26	y=419468.60	x=4421527.93
27	y=419516.46	x=4421559.21
28	y=419587.63	x=4421578.78
29	y=419572.21	x=4421722.00
30	y=419325.60	x=4421751.56
31	y=419241.32	x=4421790.04

